

QENDRA E BURIMEVE PËR SHOQËRI CIVILE NË KOSOVË

THIRRJE PËR APLIKIM PËR SHKOLLËN E AKTIVIZMIT

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM) ftojnë të gjitha organizatat e shoqërisë civile të aplikojnë në edicionin e katërt të Shkollës për Aktivizëm që do të ofrohet në kuadër të Qendrës së Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë.

Shkolla e Aktivizmit (Shkolla) është një hapësirë për edukimin profesional të OShC-ve dhe rritje të aktivizmit e cila ka për qëllim zhvillimin e shkathtësive, dhe rritjen e kompetencës së OShC-ve të vogla, të mesme, dhe me bazë në komunitet për të rritur prezencën e tyre në komunitetin në të cilën operojnë dhe në proceset e politikëbërjes, duke ndjekur parimet e avokimit pjesëmarrës dhe transparencës. Shkolla do të ofrohet në baza të rregullta vjetore për 20-25 OShC, dhe përmban 5 trajnime të cilat janë vlerësuar si tema dhe njohuri bazë për zhvillim të organizatës dhe rritje të ndikimit përmes punës që ato bëjnë.

Poashtu, OShC-të të cilat e përfundojnë me sukses Shkollën e Aktivizmit do të kenë mundësi të përfitojnë mentorim nga ekspertë të fushave të ndryshme, me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm profesional të tyre dhe mbështetje për zbatim të strategjisë dhe qëllimeve afatgjata të organizatës, si dhe pjesëmarrje në rrjete tematike/sectorale të OShC-ve të cilat do të organizohen dhe përkrahen nga Qendra.

Të gjitha trajnimet, mentorimi dhe përkrahja e vazhdueshme ofrohen pa pagesë për organizatat e përzgjedhura. Poashtu, për pjesëmarrësit/et nga jashtë Prishtinës do të bëhet edhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit.

TEMAT E TRAJNIMEVE TË SHKOLLËS PËR AKTIVIZMIT:

- **Moduli 1: Qeverisja e brendshme dhe menaxhimi i financiar për OShC**
- **Moduli 2: Integrimi gjinor:**
- **Moduli 3: Sistemet dhe proceset për vlerësimin e ndikimit dhe ngritje të fondeve**
- **Moduli 4: Avokimi pjesëmarrës**
- **Moduli 5: Teknikat e mobilizimit të komunitetit**

ÇFARË DO TË PËRFITOJNË PJESËMARRËSIT:

Me pjesëmarrje të OShC-vë në Shkollën e Aktivizmit, secila OShC pjesëmarrëse do të jetë në gjendje:

- Të kuptojë më mirë organizimin, qeverisjen së brendshme menaxhimin financiar të organizatës;
- Të përdorë forma dhe mjete të përshtatshme për identifikim të nevojave të komunitetit për të cilin angazhohen;
- Të hartojë një strategji apo plan të qartë të aktivitetit për realizim të qëllimeve të organizatës;
- Të përfshijë integrimin gjinor në kuadër të aktiviteteve të brendshme dhe me palë të jashtë organizatës;
- Të krijojë strategji më të mirë për ngritjen e fondeve, planifikimin dhe implementimin e projektit;
- Të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes, në nivel lokal dhe qendror, me njohuri më të mira të metodave të avokimit pjesëmarrës;
- Të kuptojë më mirë dhe të jetë më kompetente në aplikimin e teknikave të mobilizimit të komunitetit;
- Krijojnë rrjet të organizatave dhe bashkëpunim me grupe të ndryshme për interesat dhe qëllime të përbashkëta të organizatës

Përgjatë pjesëmarrjes në Shkollën për Aktivizëm, dhe pas përfundimit të Shkollës pjesëmarrësit do të kenë mundësi që të përfitojnë:

- Mentorim dhe këshillim të vazhdueshëm nga ekspertë të angazhuar nga Qendra për adresim dhe avancim të çështjeve specifike të organizatës;
- Rrjetëzim dhe bashkëpunim me organizata tjera të shoqërisë civile për angazhim të përbashkët në nisma avokuese, adresim të nevojave të komunitetit, etj.

MËNYRA E APLIKIMIT

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha organizatat e shoqërisë civile që janë të regjistruara apo veprojnë në Kosovë. Secila OShC duhet të propozojë 2 deri në 5 anëtarë të stafit bazuar në përgjegjësitë e tyre brenda organizatës për të marrë pjesë në modulet e Shkollës..

KRITERET PËR APLIKIM

- Të jenë Organizatë e Shoqërisë Civile, të regjistruara në Kosovë;
- Të jenë Organizatë e Shoqërisë Civile që veprojnë kryesisht në nivel lokal;
- Të ketë aktivitet në komunitet dhe/ose interesim për përfshirje të qytetarëve/eve në punën e organizatës;
- Të ketë identifikuar si nevojë zhvillimin e dokumenteve të ndryshme të brendshme në përmirësimin e procedurave dhe rregulloreve për funksionim të organizatës;

KRITERET E PËRZGJEDHJES

Qendra e Burimeve do ta bëjë përzgjedhjen e 25 OShC-ve të cilat do të jenë pjesëmarrëse në të 5 (pesë) modulet gjatë datave të caktuara. Ato përfshijnë:

- Aplikacioni është plotësuar në tërësi dhe janë përgjigjur të gjitha pyetjeve;
- Secila OShC ka propozuar stafin (minimum 2, maksimum 5) në fushatë përkatëse në bazë të përgjegjësive të stafit;
- Rëndësia se si pjesëmarrja në Shkollë i kontribuon arritjes së strategjisë së organizatës;
- Rëndësia se si pjesëmarrja në Shkollë kontribuon në përfshirjen e komunitetit në qëllimet e organizatës;
- Kapacitetet për zhvillimin e brendshëm të organizatës në bazë të nevojave të paraqitura;

Vetëm OShC-të e përzgjedhura do të kontaktohen përmes e-mailit. Qendra e Burimeve të Shoqërisë Civile në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me OSHC-të e përzgjedhura do të bëjë edhe caktimin e anëtarëve pjesëmarrës në secilin modul.

Pas përfundimit të Shkollës, nga pjesëmarrësit pritet që t'i shkëmbejnë njohuritë dhe përvojat brenda organizatës së tyre.

Par përfundimit të Shkollës, secili pjesëmarrës do të pajiset me *certifikatë të pjesëmarrjes*.

DORËZIMI I APLIKACIONEVE

OShC-të e interesuara duhet të plotësojnë aplikacionin duke klikuar [këtu](#).

Do të merren në konsideratë vetëm aplikacionet që përmbushin të gjitha kërkesat e specifikuara në këtë thirrje dhe formular të aplikimit. Afati i fundit për aplikim është **20 nëntor 2023, në ora 23:59**.

Të gjitha pyetjet ose informata shtesë që keni në lidhje me Shkollën ose me procesin e aplikimit mund t'i dërgoni përmes postës elektronike në rc-kosovo@kcsfoundation.org.

Inkurajohet aplikimi i OShC-ve të vogla, atyre të sapo-themelura dhe jashtë Prishtinës.

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë është projekt që bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Suedia dhe implementohet nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM).